

LAJMERIM

Bazuar në V.K.M-në Nr. 39 datë 23.01.2019, “ Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” të ndryshuar, studentët e ciklit të parë të studimeve “Bachelor” përfitojnë bursë financiare për vitin akademik 2022 – 2023, pasi plotësojnë kriteret e pikave të VKM-së si më poshtë:

1. STUDENTËT E SHKËLQYER

- a) Studentët e pranuar në vitin e parë akademik, në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, që përlllogaritet si mesatare e thjeshtë e treguesve, si më poshtë:
- b) Studentët e regjistruar në programet e studimeve profesionale, programet e ciklit të parë të studimeve, programet e integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitet pas të parit, me notë mesatare vjetore të ponderuar nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të vitit paraardhës akademik të përlllogaritur me kreditet dhe notat e atij viti akademik nga institucionet publike të arsimit të lartë. Studentët duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore e ponderuar.”.

2. STUDENTËT NË NEVOJË

- a) Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike;
Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:
 1. Fotokopje të kartës së ID;
 2. Certificate familjare të tre muajve të fundit;
 3. Vërtetim nga organet e qeverisjes vendore qe familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike, ku të specifikohet numri i dosjes;
- b) Bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare;
Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:
 1. Fotokopje të kartës së ID;
 2. Certificate familjare të tre muajve të fundit;
 3. Vërtetim studenti për bashkëshorten apo bashkëshortin student (e)-dokument orgjinal.
- c) Studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;
Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:
 1. Fotokopje të kartës së ID;
 2. Vërtetim lëshuar nga KMCAP (dokument fotokopje e noterizuar);
 3. Vërtetim nga organet e qeverisjes vendore për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar-dokument orgjinal lëshuar nga këto organe.

ç) Studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të kartës së ID;
2. Certifikatë familjare të tre muajve të fundit;
3. Vërtetim lëshuar nga KMCAP (dokument fotokopje e noterizuar), për të dy prindërit;
4. Vërtetim nga organet e qeverisjes vendore për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar-dokument origjinal lëshuar nga këto organe për të dy prindërit.

d) Studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton;

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të kartës së ID;
2. Certifikatë familjare të tre muajve të fundit;
3. Vërtetim nga sigurimet shoqërore për pension pleqërie për prindërit-dokument origjinal;
4. Certifikatë vdekje e prindit (ne rast se njëri nga prindërit pensionist nuk jeton).

dh) Studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë;

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të kartës së ID;
2. Certifikatë familjare të tre muajve të fundit;
3. Vërtetim studentit për dy fëmijët e lindur (vëllezërit dhe motrat) në radhë, para studentit aplikues;

e) Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të kartës së ID;
2. Fotokopje e noterizuar e dokumentit për statusin e jetimit;
3. Certifikatë familjare të tre muajve të fundit;
4. Certifikatë e humbjes së të dy prindërve.

ë) Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç;

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të kartës së ID;
2. Certifikatë familjare të tre muajve të fundit;
3. Fotokopje e noterizuar e Vendimit të Gjykatës i formës së prerë.

f) Studentët që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

1. Fotokopje të kartës së ID;
2. Certifikatë familjare të tre muajve të fundit;

3. Dokument vërtetues lëshuar nga organet përkatëse, për studentët që kanë përfituar statusin ligjor si viktimë të trafikut- dokument origjinal/ fotokopje e noterizuar.

g) Studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.”.

Dokumentacioni shoqëruar i domosdoshëm:

1. Fotokopje të kartës së ID;
2. Certifikatë familjare të tre muajve të fundit;
3. Certifikatë e humbjes së jetës së prindit (njërit);
4. Vërtetim lëshuar nga institucioni përkatës i humbjes së jetës së prindit në krye të detyrës-dokument origjinal.

“Studentët aplikojnë për bursë financiare sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, me dokumentacionin provues të plotësimit të kriterëve.

Studentët përserites të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) nuk përfirojnë bursë financiare.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit për studentët që aplikojnë për bursë financiare, është deri më datën 01.12.2022.

Studentët që aplikojnë brenda kësaj date do të përfitojnë bursë financiare nga data e fillimit të vitit akademik 2022-2023, ndërsa studentët që aplikojnë pas kësaj date, pagesa e bursës financiare do të realizohet në perputhje me Vendimin nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave, nga muaji pasardhës i aplikimit.

DEGA E FINANCËS

ADMINISTRATORI